

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Mbikëqyrësi

21 maj 2021

Të dashur prindër dhe familje të Rajonit Shkollor të Filadelfias,

Duke shikuar përpara drejt vitit shkollor të ardhshëm, dua të riafirmoj atë që kam thënë disa herë më parë: **qëllimi ynë për vitin shkollor 2021-2022 është që t'i mirëpresim të sigurt të gjithë nxënësit tanë gjatë kthimit në shkollë për mësim të plotë fizikisht pesë ditë në javë, duke filluar të martën, me 31 gusht 2021 – dita e parë e shkollës.** Ne e dimë se kthimi i nxënësve në klasë me shokët dhe mësuesit e përkujdesur, është mundësia më e mirë për t'i ndihmuar ata që të shërohen dhe të rimëkëmben nga pasojat dërrmuese të pandemisë COVID-19.

Gjatë një konference shtypi të mërkurën e kaluar, unë qëndrova krah për krah me Kryetarin e Bashkisë Jim Kenney, Presidentin e Federatës së Mësuesve të Filadelfias Jerry Jordan, Presidenten e Degës së Filadelfias të Shoqatës së Komënuelthit për Administratorët e Shkollave Dr. Robin Cooper, Presidenten e Local 634 Nicole Hunt dhe Royce Merriweather, Presidentin e Shoqatës së Policisë së Shkollave të Filadelfias. Së bashku ne riafirmuam përkushtimin tonë të përbashkët drejt këtij qëllimi.

Konferencën e plotë të shtypit mund ta shikoni këtu: <https://youtu.be/FSf4viDZkaI>

Ndërsa ky qëllim varet nga Qendrat e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve (CDC) dhe Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias që të lehtësojnë zyrtarisht të gjitha kërkesat e distancimit social, ka shumë gjëra të cilat na japin vetbesim se do të mund të rifillojmë mësimin fizikisht në mënyrë të sigurt në vjeshtë, duke përfshirë:

- përqindjet e ulëta (dhe në rënie) të transferimit në Filadelfia,
- lehtësimi në vazhdim i kufizimeve të lidhura me COVID-in në mbarë qytetin dhe vendin,
- numri në rritje i të rriturve dhe nxënësve që po vaksinohen,
- numri i ulët i rasteve pozitive me COVID-19 në shkollat tona që kur filluam mësimin fizikisht në mars 2021 (shumë poshtë 1%), dhe
- rritja e rëndësishme e mbështetjeve për shkollat dhe nxënësit të cilat po i planifikojmë për të shqyrtuar në mënyrë të paanshme pasojat e COVID-19-ës.

Mund të na ndihmoni që t'i specifikojmë më tutje planet tona duke marrë pjesë në një pyetësor të shkurtër që zgjat vetëm 10 minuta. Pyetësori, të cilin mund ta gjeni [këtu](#), mbyllet të premtën e ardhshme, me 28 maj në orën 5 pasdite. I inkurajoj të gjithë që të ndajnë mendimet dhe komentet e tyre.

Faleminderit për mbështetjen tuaj ndërsa planifikojmë së bashku për një vit shkollor të suksesshëm 2021-2022.

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr.".

William R. Hite Jr., Ed.D.
Mbikëqyrësi
Rajoni Shkollor i Filadelfias